


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	14.07.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 157/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.55/2017 të dt. 07.07.2017 për lëndën Munir Luboteni Nr. 04-353/01-34864 për renovimin /restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim, në ngastrën kadastrale Nr.1910-0 Z.K. Prizren/

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 55/2017
Datë: 07.07.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i kërkesës/projektit për renovimin/ restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim, në ngastrën kadastrale Nr. 1910 – 0. Z.K. Prizren..
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqytjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Munir Luboteni nga Prizreni, ka parashtruar kërkesë për renovimin/ restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim, në ngastrën kadastrale me Nr. 1910 – 0. Objekti që do të renovohet gjendet në zonën e VI-të (zona e banimit dhe shfrytëzimit të përzier) sipas planit të konservimit. Parcela për renovim të objektit gjendet pranë Xhamisë së Mehmed Pashës (Bajraklisë) që është në Listën e MKRS-së – Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti në fjalë gjendet edhe në shtojcën e II – të, si Objektet e Banimit me nr. rendor 51 (shtëpi – selamllëk e Bajram Sokolit) të Ligjit Nr. 04/L – 066 për Qendrën Historike të Prizrenit.


Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka konkluduar si më poshtë:

1. Aprovohet projekti për renovimin/ restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim, në ngastrën kadastrale me nr 1910-0 me kusht që:

- 1.1.Të ruhet sa më shumë nga materiali dhe struktura origjinale e ndërtesës;
- 1.2.Të ruhen karakteristikat e kulmit origjinal.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;



Agim Gërguri

U.D. Drejtor